

FJALA E DEPUTETES ALBANA VOKSHI

E ENJTE 24 MARS 2022

Nuk ka pse të shkojë zonja ministre në Dibër, kur qindra banorë e presin aty. Hajde, të shkojmë së bashku. Ju ftoj të dalim së bashku për t'i takuar. Kur thoni këtë është të qeshësh apo të qash. Shtirje, hipokrizi, që i shërben vetëm propagandës suaj, por propaganda juaj nuk i strehon dot qytetarët, nuk i bën dot me shtëpi, as nuk u jep dot bukë fëmijëve të tyre dhe as nuk u jep dot ilaçe të sëmurëve. Pse nuk i takoni banorët e "5 Majit". Pse nuk e takoni Lauretën, që e arrestuar 3 ditë, e futët në burg, duke i lënë fëmijët e saj të mitur 1 vjeç e gjysmë dhe 4 vjeç pa përkujdesjen e nënës? Jo vetëm kaq, por meqenëse guxoi të kundërshtonte, i vendosët edhe një gjobë 13 milionë lekë për një shtëpi prej druri, të cilën ju refuzuat prej vitesh t'ia regjistronit. Nuk e regjistruat, por gjobën e vendosët 13 milionë për atë ndërtim pa leje.

Pse nuk e takoni më Lizën, që është ende jashtë dhe nuk ka strehim? Pse nuk reaguat kur policët, për turpin e madh të tyre, tërhiqnin zvarrë një nënë 78-vjeçare vetëm pse mbronte shtëpinë e saj, familjen e saj, fëmijët e saj? A keni turp? Ndërkohë që krimi qeveris në rrugë, ju merrni zvarrë nëna, gra, prindër para syve të fëmijëve. Prej sa muajsh kërkojnë t'ju takojnë banorët e Laprakës? Prej sa muajsh kërkojnë informacion, kërkojnë të dinë se çfarë do të ndodhë me banesat e tyre? Ata kërkojnë vetëm një gjë, transparencë dhe informacion. Kërkojnë të respektohen. Kërkojnë që ju të respektoni ligjin dhe Kushtetutën. Pse nuk i takoni banorët e Paskuqanit? Aty jashtë janë të gjithë. Kam një video, të cilën ju ftoj ta shikoni, zonja Ministre. Është një nga shtëpitë e "5 Majit". Shikoni brenda shtëpisë. Po hidhet gaz. Janë 4 fëmijë në këtë shtëpi, më i vogli është 2 vjeç, më i madhi është 12 vjeç, bashkë me nënë, me gjyshen 80-vjeçare.

Përveç dhunës, nuk kursyet të hidhnit as gazin helmues në kundërshtim të çdo ligji, në kundërshtim të konventave ndërkombëtare. Si nuk u interesuat për këtë familje? Është shtëpia e Ndue Markut dhe për ironi të fatit, kjo shtëpi nuk ishte as në listën e shtëpive që duheshin shembur. Shikojini këto pamje! Nuk janë në Ukrainë, jo, janë në Shqipëri, janë te "5 Maji". Duket dhuna policore, krevatet e fëmijëve, sepse ju nuk i lejuat banorët të futeshin, nuk lejuat fëmijët të merrnin lodrat e tyre të fëmijërisë, nuk lejuat të sëmurët të hynin për të marrë mjekimet dhe ilaçet e tyre. Asgjë. Gaz, dhunë, shkatërrim në investimin e një jete të tërë, shembur për 5 minuta, bërë hi. Sigurisht, edhe ata ndërkombëtarë, që vrapojnë për të folur për çdo gjë në Shqipëri, këtë herë, sikurse edhe herët e tjera në Astir dhe në Bregun e Lumit, heshtën. Pse e nisa me këto pamje, që si dejavu na sjellin në mendje Astirin apo Bregun e Lumit? Sa herë kam pasur takime me banorët e Bregut të Lumit, të zonës sime, u kam thënë: para kutisë së votimit mbani mend vetëm këto pamje, mbani mend dhunën e ushtruar ndaj jush, gazin që ju hodhën në orën 5:00 të mëngjesit, mbani mend se si jua hodhën nga çatitë.

Kjo është fytyra e vërtetë e qeverisjes së Edi Ramës. Dje ishte Astiri dhe Bregu i Lumit, sot është Lapraka, është Paskuqani dhe "5 Maji". Nesër do të na trokasin të gjithëve në shtëpitë tona. Askush nuk do t'i shpëtojë regjimit të Edi Ramës nëse ne nuk reagojmë. Në emër të kujt është kjo dhunë policore? Në emër të kujt shkelet Kushtetuta? Në emër të kujt shkelen dhjetëra ligje? Në emër të kujt IKMT-ja guxon

dhe shkon shtëpi më shtëpi, duke çuar kodin e shkatërrimit të banesave pa asnjë njoftim apo shkresë? Artan Lame e paralajmëroi këtë që po ndodh, kur tha: “Jo, nuk do t’i prishim shtëpitë para zgjedhjeve, sepse na humbin votat e Partisë Socialiste”. Tani janë turrur si një rrjet i mirëorganizuar kriminal për të gjetur zonat e Tiranë, por jo vetëm, që kanë probleme të shumta legalizimi. Dhe çfarë bëjnë? I grabisin.

Sot në Shqipëri nuk vlejnë më as certifikatat e regjistrimit. E gjitha kjo ka vetëm një emër: grabite, vjedhje, korrupsion. Nuk është në emër të interesit publik, jo. Po i grabisin pronat. Për çfarë? Për fitime marramendëse. E dëgjuat edhe ministren të “5 Maji”: “Është projekti i Boerit, i miratuar në vitet 2017–2018, nuk ka të bëjë fare me projektin e rindërtimit. Nga 493 mijë metra katrorë a e dini sa do të përdoren për banorët që patën probleme me shtëpitë e tyre për shkak të tërmetit apo për ata që sot po i shpronësoni me zor? Do të përdoren vetëm 165 mijë metra katrorë, ndërkohë që 328 mijë metra katrorë i shkojnë privatit për ndërtim. Pra, po grabitet prona e qytetarëve vetëm në emër të fitimeve të privatëve të lidhur me qeveritarët. Në Laprakë kanë devijuar gjurmën. Unë do t’ju tregoj edhe projektin e Laprakës, për të parë sa është devijuar gjurma, pavarësisht se ministrja një herë e pranon, një herë nuk e pranon. Kjo me vizë të kuqe, tregon projektin fillestar, ndërsa kjo me vizë të zezë tregon projektin e tanishëm. Çfarë ka ndodhur këtu? Pse është devijuar projekti? Kush janë ata që do të ndërtojnë? Kush janë oligarkët që kanë detyruar devijimin e gjurmës? Po kështu edhe në Shkozë. Në vend të 7 shtëpive, preken dhjetëra shtëpi. Pra, projekti është devijuar edhe në Shkozë.

Gjithashtu, edhe në Paskuqan, nga 2-3 shtëpi, që prekeshin në projektin e parë, tani preken 100 shtëpi, një nga banorët e Paskuqanit e konsideroi gjenocid, dhe e gjitha kjo në emër të vjedhjes, në emër të grabitjes, në emër të korrupsionit. Nëse flasim për transparencë, ju përmendët shumë shkresa, zonja Ministre, por unë kam dhjetëra shkresa të tilla, ku në njërin thuhet se është devijuar, në tjetrën thuhet se nuk është devijuar. Institucionet bien në kontradiktë me njëra-tjetrën. Ndërkohë, banorëve të Laprakës në përgjigjen e fundit u keni thënë se nuk ka projekt të përfunduar. Për çfarë shkoni dhe i terrorizoni banorët kur as projektin nuk e keni përfunduar?! Kjo është shkresë zyrtare nga Autoriteti Rrugor Shqiptar. Ka apo nuk ka projekt? Pse i çoni zyrtarët si banda, duke u rënë dyerve dhe duke u thënë: “Kjo prishet dhe kjo nuk prishet”? Kush ua jep juve këtë të drejtë? Përmendët se janë brenda programit social. Çfarë po u jepni në këmbim? Pasi ua shembni shtëpitë, pa firmosur aktmarrëveshje, u jepni 180 mijë lekë të vjetër. Në cilën zonë të Tiranës një familje, që mund të ketë 2 ose 3 kurorë, mund të gjejë shtëpi me qira me 180 mijë lekë të vjetër?

Zonja Ministre, a do ta gjenit ju një shtëpi me qira me 180 apo 200 mijë lekë? Gjithashtu, përmendët një aktmarrëveshje, që është për turp. A do ta firmosnit ju për veten tuaj, zonja Ministre? Po ministrat e tjerë a do ta firmosnin këtë aktmarrëveshje, që nuk siguron asgjë, por ta grabit sot pronën, duke thënë se do ta kthejë në një të ardhme, në bazë të një ligji që do të miratohet në të ardhmen? Nuk ka asnjë siguri nëse do ta marrë sërish, sepse çdo gjë rregullohet në të ardhmen. Ia grabisni sot për fitime marramendëse, duke u thënë se mund tua jepni pas 1-2 vjetësh, por jo të gjithë pronën, 500–600 metra katrorë, por vetëm atë të ndërtesës, të objektit. Çfarë i dini njerëzit ju, budallenj? Si mund të shkoni dhe t’u jepni këtë marrëveshje, që asnjëri nga ju nuk do ta kishte firmosur kurrë për familjen e tij? Pavarësisht faktit se banorëve të prekur u janë marrë për vite me radhë taksa e banesës nga autoritetet shtetërore, kur vjen puna për kompensimin e drejtë të pronave të tyre, kjo gjë nuk ndodh, sepse ato banesa janë zvarritur në proces qëllimisht. Për vite me radhë u është refuzuar legalizimi dhe

rrjedhimisht ata sot hidhen në rrugë ose pa kompensim, ose me një kompensim qesharak, ose duke marrë në shkëmbim një banesë në të ardhmen. Banorët janë njoftuar për lirim të objekteve në një datë të caktuar, pa asnjë vendim për shembje, e përmendët edhe ju, duke mos u lënë mjaftueshëm kohë as për ankimim.

Banorëve po u merren ndërtesat, po u shemben pronat, por nga ana e bashkisë, ARRSH-së dhe ministrisë suaj nuk u janë bërë me dije procedurat që do të ndiqen në të ardhmen. Fshehja e këtij informacioni për projektet tregon se janë okulte, me shkelje të rënda ligjore, gjë që sjell pasoja serioze për të gjithë ligjshmerinë. Po ashtu është shkelur ligji “për shpronësimet”, pasi neni 3 parashikon: “Shpronësimi dhe marrja në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, realizohet në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara në këtë ligj, duke garantuar transparencën, barazinë e shtetasve dhe mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të tyre pasurore”. Ligji, duke pasur parasysh likuidimin e plotë për vlerën e shpronësimit të subjektit, kërkon përcaktimin e një afati përmbysës të këtij procesi brenda një kohe të shkurtër të arsyeshme, si pjesë e një procesi të rregullt administrativ. Asnjë shpronësim apo shembje banese nuk mund të jetë e ligjshme nëse banori nuk e ka marrë pagesën për shpronësim. Një tjetër shkelje e ligjit është edhe fakti që nuk ekziston një listë shteruese, një herë një listë, pastaj një listë tjetër, devijohet projekti, hiqen disa emra, shtohen disa të tjerë, sipas interesit momental. Gjithashtu, në ligjin nr. 8561, në neni 26, pika 3, thuhet: “Shpronësimi quhet i pavlefshëm në rast se brenda afateve të parashikuara në nenin 23 nuk është kryer pagesa për llogari të pronarëve të shpronësuar”. Në nenet 41/42 të Kushtetutës, konkretisht neni 41\4 thuhet: “Shpronësimet ose kufizimet e të drejtës së pronës që bazohen në shpronësim, lejohen vetëm përkundrejt shpërblimit të drejtë”. Në këtë kuadër, duke pasur parasysh faktin që ka zvarritje të procedurave të kompensimit të banorëve për efekt të shpronësimit dhe verifikimeve të tjera shtesë të pasurive që preken nga zbatimi i projektit, kjo procedurë shpronësimi është e pavlefshme në kuptimin e dispozitës ligjore.

Nga veprimet tuaja keni cenuar parimin kushtetues të barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit, neni 18 i Kushtetutës; keni shkelur nenet 11 dhe 49 të Kushtetutës, duke cenuar parimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike të shtetasve; keni shkelur nenin 1 të protokollit të Konventës Europiane dhe nenin 8 të kësaj Konvente. Ka disa raste të tilla të trajtuara në Gjykatën e Strasburgut, por nuk kam kohë për t’u ndalur në to. Dua t’ju bëj me dije se janë mbi 1000 banesa, rreth 1500 familje, që preken nga këto projekte. Asnjë banor nuk është kundër zhvillimit, e përsërisim, por ata duan informacion, duan respektimin e të drejtave kushtetuese dhe zbatimin e ligjeve në fuqi; nuk duan lëmshë, kërkojnë dinjitet, kërkojnë zbatim kushtetues. Banorët kërkojnë t’i informoni në kohë për çdo hap, për çdo procedurë dhe të respektoni ligjin, të gjitha kategoritë të trajtohen njësoj në skemën e shpronësimit, dëmshpërblimi të jetë me vlerën e tregut, madje të rishikohet formula për dëmshpërblim të drejtë para se t’u prishen shtëpitë.

Të nderuar banorë, që edhe sot po protestoni,

Të nderuar qytetarë,

Rendi demokratik ka rënë; jemi në një regjim. Regjimet rrëzohen nga protestat. Mos reshtni, mos heshtni! Ngrihuni për të drejtat tuaja dhe të fëmijëve tuaj! Faleminderit!